

Mjedisi i Biznesit dhe Aspektet Legale EKOM206

Hyrje

Rrethina ku veprojnë bizneset, ajo mikro apo makro, ka rëndësi të veçantë në performancën e tyre. Në procesin e shndërrimit të inputeve në autpute bizneset operojnë në kontekst të një rrethine e cila është tejjet komplekse dhe e paqëndrueshme, e cila në asnjë mënyrë nuk mund të injorohet kur të analizohen aktivitetet e bizneseve. Lënda do të fokusohet në rrethinën e brendshme dhe atë të jashtme të biznesit. Rrethina e jashtme do të përfshijë dimensionet politike, ekonomike, sociale, teknologjike dhe ato ligjore. Në vijim, lënda fokusohet në aspektet që kanë të bëjnë me vet firmën, pastaj me industrinë pjesë e së cilës është firma, tregun së cilit i takon, dhe rolin e qeverisë në këtë kontekst. Çështja e fundit që do të trajtohet ka të bëjë me ndyshueshmërinë e ambientit në të cilin operojnë firmat dhe masat që duhen ndërmarrë nga bizneset si rezultat i kësaj. Duhet potencuar krejt në fund se globalizimi i aktivitetit ekonomik (dhe mundësitë e reja që gjeneron ky proces) imponojnë që dimensionet e ndryshme të ambientit ku operojnë firmat duhet trajtuar nga prizmi global. Dhe kjo do të jetë edhe qasja gjatë mësimit të kësaj lënde.

Qëllimet

Objektivi i kësaj lënde është t'u mësojë studentëve premisat kryesore të ambientit në të cilin bizneset operojnë, me theks të veçantë në Kosovë.

Rezultatet e pritura të lëndës

- Të kuptojë si dhe të shkruaj mbi aspektet teorike dhe praktike të mjedisit biznesor nga këndvështrimi i kompanive.
- Të kuptoj si dhe të shkruaj mbi natyrën e çështjeve juridike me të cilat ballafaqohen afaristët, kuptimin e elementeve bazike të marrëdhënieve ndër-biznesore juridike, si dhe kuptimin e metodave për njohjen paraprake të problemeve të mundshme juridike në ambientin biznesor në vend dhe ndërkombëtarisht.

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Mjedisi i biznesit – konceptet dhe konteksti Rrethina e jashtme makro:rrethina politike	- Prezantimi i objektivave dhe i programit të punës (vëllimi, struktura, sistemi i vlerësimit, literatura) - Sistemet politike - Institucionet - Sistemet ekonomike
2	Rrethina e jashtme: rrethina ekonomike I	- Rritja ekonomike - Papunësia: niveli, llojet dhe efektet
3	Rrethina e jashtme: rrethina ekonomike II	- Politika tatimore - Inflacioni - Politika fiskale - Marrëdhëniet tregtare
4	Rrethina e jashtme: rrethina sociale Rrethina e jashtme: rrethina teknologjike	- Natyra e mjedisit social - Aspektet demografike - Kultura dhe dimensionet tjera sociale Ndryshimet teknologjike dhe ndikimi në - Reduktimin e kostove - Rritjen e produktivitetit - Mënyrat e reja të punës - Krijimin e sistemeve dhe proceseve efçente
5	Mjedisi biznesor në Kosovë	- Profili - Barrierat - Politikat

6	Tregjet ndërkombëtare dhe globalizimi	- Aspektet e ndryshme të mjedisit biznesor në kontekst global
7	Rrethina e jashtme: rrethina ligjore	- Kontratat - Mbrojtja e konsumatorëve - Legjislacioni i punës - Mbrojtja ligjore e investimeve - Barazia në treg (konkurrenca e ndershme)
8	Rrethina e jashtme: rrethina ligjore	- Pronësia intelektuale - Etika dhe përgjegjësia sociale - Aspektet e ndryshme juridike ndërkombëtare

Informata shtesë 1:

(a) Në mënyrë që studentët të përvetësojnë më mirë lëndën, të njëjtit preferohet të kenë njohuri bazike nga mikroekonomia; (b) Kjo lëndë do t'i ndihmojë studentëve që të kuptojnë modelet ekonomike të cilat sqarojnë, në mënyrë të thjeshtësuar, dukuritë praktike të sjelljes së konsumatorëve, firmave dhe qeverive.

Informata shtesë 2:

(a) Gjatë ligjërimit, do të përdoret projektori për të paraqitur pikat kryesore të temës; (b) Grafikonet do të vizatohen në tabelë; (c) Materialet shtesë (përfshirë prezantimet, detyrat dhe materiale tjera për lexim) publikohen rregullisht në platformën e-learning.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Detyra	50		Punimi seminarik: (punim prej 1,000 fjalëve në një temë e caktuar; punë individuale)
2	Pjesëmarrja	10		Pjesëmarrja aktive në ligjerata dhe ushtrime: (prezantim, diskutim, kuize)
3	Provimi Final	40		Provimi final ku studentët i përgjigjen nga një pyetjeje nga mjedisi biznesor si dhe nga aspektet legale.

Kushtet e përsëritjes:

Sipas rregullores së studimeve të Kolegjit Riinvest, studenti ka të drejtë t'i nënshtrohet provimit për një lëndë deri në tri herë. Nëse studenti nuk arrin që të kalojë provimin në mundësinë e parë pas përfundimit të ligjëratave, atëherë pikët e grumbulluara gjatë ligjëratave përmes vijueshmërisë dhe kolokviumeve i ruhen deri në mundësinë e fundit që studenti ka për t'ju nënshtuar provimit. Nëse studenti nuk arrin që ta kalojë lëndën edhe pas herës së tretë, atëherë studenti duhet ta përsërisë gjithë lëndën.

Burimet:

- - Campbell, D. and Craig, T. (2005) Organisations and the Business Environment, Oxford: Elsevier Butterworth-Heinemann. - Worthington, I. and Britton, C. (2006), The Business Environment, Essex: Prentice Hall. - Materialet shtesë të përgatitura dhe rekomanduara nga mësuesit - Botime nga fondi hulumtues i Riinvestit

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	2	(i)
Ushtrime:	1	(i)
L+U:	24	(i)
Seminar/praktike.:	50	(i)
Studim i vazhdushem:	50	(i)
Pregaditja e Provimit:	30	(i)
Pjesemarrja ne teste:	0	(i)
Pjesemarrja ne provimin final:	2	(i)
Me profesorin dhe asistentin:	1	(i)

Total Ore: **157**



ECTS: **6**

